

Kastrioti/ Ramadan Ndreu: "Kishim mundesi te fitonim pike"!

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 28 Shtator 2013 19:59



Trajneri i Kastriotit Ramadan Ndreu vleresoi skuadren mike, por sipas tij skuadra e Kastriotit kishte mundesi per tu shkeputur me pike nga ky takim. "E kisha parashikuar të vështirë ndeshjen me Kukësin. Duhet pranuar se skuadra kukesian është skuadër e forte. Me pak kujdes mund të mos ndeshkoheshim. Megjithate, do të analizojmë në hollësi të metat dhe dobësite e konstatuara në këtë ndeshje dhe do mundohemi ti rikuperojme ato ne ndeshjen e ardhme. Ne takimin e rrathes kemi nje tjetër përballje të vështirë që është ajo me Tiranën", u shpreh trajneri i Kastriotit pas ndeshjes se humbur me Kukësin